



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 2393 Prot.

Fier, më 20.02 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 24, datë 20.02. 2026

për dhënie ndihme shtetërore financiare të familjeve të fshatrave të Njesisë Administrative Levan nga përmbytja nga lumi Vjosë në datën 08.01.2026 dhe familjeve të Njësive Administrative nr.2, Mbrostar Ura dhe Libofshë nga përmbytja nga lumi Seman në datën 11.01.2026

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.118, datë 11.12.2025 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2026*" si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmet e shkaktuara nga përmbytja e lumit Vjosë në datën 08.01.2026, dëmet e shkaktuara nga përmbytja e lumit Seman në datën 11.01.2026 dhe procedurave të Komisionit të Vlerësimit të Këshillit të Qarkut Fier, nëpërmjet shkresës zyrtare nr.142/1.prot, datë 17.02.2026 "Vlerësim dëmi", si dhe Preventivave bashkëlidhur kësaj shkrese Kryetari i Bashkisë,

PROPOZON:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Fier për dhënie ndihme shtetërore financiare të familjeve të fshatrave të Njësive Administrative Levan, Mbrostar Ura e Libofshë të dëmtuara nga përmbytja e lumit Vjosë në datën 08.01.2026 dhe nga lumi Seman në datën 11.01.2026, sipas listës emërore të familjeve të përmbytura në muajin Janar 2026.
2. Të miratojë listën emërore të familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet e lumenjve Vjosë dhe Seman gjatë muajit Janar 2026 si dhe dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Fier për këtë qëllim me vlerat përkatëse.
Bashkëlidhur lista emërore e familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet e lumenjve Vjosë dhe Seman gjatë muajit Janar 2026.

3. Të miratojë vlerën e ndihmës për çdo familjeve të dëmtuar nga përmbytjet e lumenjve Vjosë dhe Seman gjatë muajit Janar 2026 sipas tabelës bashkëlidhur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip BANI

Drejtoria Juridike
Esmeralda KAPLLANAJ

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera ÇINA

KRYETARI
Armando SUBASHI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR**

Eraldi QIRIO

